



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

PROJEKT - REZOLUTË

“PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ORGANIT TË PROKURORISË PËR VITIN 2017”

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

- Prokurorinë e Republikës së Shqipërisë si institucion kushtetues i pavarur që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit;

- Rolin kushtetues dhe ligjor të Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë, në drejtimin e hetimit dhe luftës ndaj formave të ndryshme të kriminalitetit si jetike për forcimin e shtetit të së drejtës dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

- Angazhimin e veçantë të Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë përgjatë vitit 2017, në drejtim të hetimit dhe procedimit për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimi të narkotikëve, dhe kultivimit të bimëve narkotike;

Kuvendi Shqipërisë duke çmuar se:

- Ligjshmëria, pavarësia institucionale, përgjegjshmëria dhe integriteti i lartë moral dhe profesional i prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, janë parimet bazë që duhet të udhëheqin Prokurorinë e Republikës në ushtrimin e ndjekjes penale efikase dhe luftën ndaj kriminalitetit;

- Sfdat bashkëkohore që kërkon procesi i integritetit në Bashkimin Europian, veçanërisht në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, angazhimi në realizimin dhe zbatimin i reformës në drejtësi, duhet të jenë fokusi qendror i veprimtarisë së Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë për gjatë vitit 2018;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se Organi i Prokurorisë gjatë vitit 2017:

- Ka trajtuar 58291 materiale kallëzuese që përbën një rritje prej 1,64 % në krahasim me vitin 2016, nga të cilat vetëm 148 janë për vepra penale të filluara kryesisht nga organi i akuzës;

- Megjithëse ka pasur rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, në krahasim me vitin 2016, pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2017, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi vazhdon të jetë në nivele shumë të ulta, 0,87 % e numrit të përgjithshëm të procedimeve;

- Nga 148 çështje penale të filluara kryesisht nga organi i akuzës, vetëm 46 çështje janë filluar kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit, ku vendin kryesor e zë vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal;

- Procedimet ndaj formave të krimit të organizuar për veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale janë pothuajse në të njëjtat nivele si në vitin 2016. Gjatë vitit 2017, janë regjistruar 17, procedime penale me 34, të pandehur për vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, 16 nga këto procedime për nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”;

- Masat e sekuestrove mbi pasuritë kriminale të vendosura, dhe konfiskimet e produkteve të krimit vazhdojnë të jenë në nivele të ulta, organi i akuzës ka paraqitur në gjykatë 4 kërkesa për sekuestrim pasurie dhe 7 kërkesa për konfiskim pasurie;

- Ka pasur rritje të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara në gjykatë për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”; ndërsa procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotikëve”, janë ulur krahasuar me vitin 2016;

- Në saj të teknikave speciale hetimore është arritur në arrestimin/ndalimin e 475 personave të dyshuar për vrasje, trafikim të lëndëve narkotike, korrupsion, trafikim të armëve, e vepra të tjera, duke parandaluar pasoja të rënda për qytetarët;

- Është suprimuar Drejtoria e Inspektimit në Prokurorinë e Përgjithshme, veprim ky në kundërshtim me dispozitat kalimtare të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilave është parashikuar se deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm heton shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve të Prokurorisë së Përgjithshme;

- Në zbatimin të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, organi i akuzës ka verifikuar zyrtarë të të gjitha niveleve; për 252 subjekte deklaruese ka rezultuar se kanë deklaruar të dhëna të pavërteta/rreme në formular duke konsumuar veprën penale të “Falsifikimit të vulave, të stampave ose formularëve” parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal;

- Dhuna në familje vazhdon të jetë një fenomen shqetësues, organi i akuzës ka regjistruar 1469 procedime penale për vepra kundër fëmijëve, martesës dhe familjes nga të cilat 1105 procedime penale janë dërguar për gjykim;

- Numri më i madh i tre grup veprave penale që konstatohen në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm për procedime të regjistruara, sipas strukturës së Kodit Penal janë; veprat penale të vjedhjes së pasurisë, veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, veprat penale që çenojnë regjimin juridik të tokës;

- Në raport nuk ka informacion lidhur me hetimet penale ndaj personave juridik; cili ka qënë historiku i procedimeve të dërguara në gjykatë për këto subjekte, sipas dispozitave të ligjit nr, 9754, datë 14.6.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridik”;

Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Prokuroria e Republikës së Shqipërisë për vitin 2018:

- Rritjen e numrit të hetimeve në tërësi dhe në veçanti hetimeve proaktive kundër krimit të organizuar, korrupsionit në nivel zyrtarësh të lartë dhe të mesëm; funksionarëve të sistemit të drejtësisë, të zgjedhurve në nivel qendror dhe vendor;

- Rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimi të narkotikëve, dhe kultivimit të bimëve narkotike;

- Rritjen e numrit të hetimeve pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë kriminale të organizuar, sipas ligjit Antimafia;

- Garantimi e ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e reja që priten të krijohen Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në procesin e vlerësimit profesional dhe hetimin disiplinor të prokurorëve;

- Forcimin e bashkëpunimit mes Prokurorisë dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, si dhe agjencive të tjera ligjzbatuese, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe përdorimin efektiv të metodave speciale të hetimit për dokumentimin e veprave penale kundra korrupsionit dhe krimeve të rënda;

- Forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë e huaja ligjzbatuese me qëllim luftën ndaj krimit të organizuar dhe veprave penale që lidhen me pastrimin e parave; si dhe marrjen e masave për adresimin e problematikave që konstatohen nga Progres - Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA - ve, lidhur me problematikat e krimit të organizuar në Shqipëri;

- Forcimin e bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, për parandalimin e krimeve kompjuterike që përdoren për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale, si dhe ato për qëllime të financimit të terrorizmit;

- Ashpërsimin e politikës penale për masat e sigurisë dhe të dënimit kundër: krimit të organizuar, korrupsionit, dhunës në familje, krimeve kundra jetës, pastrimit të parave, krimit ekonomik dhe financiar, amëmbjates pa leje, krimit që lidhet me procesin zgjedhor, personave përsëritës në krim, krimit mjedisor;

- Të ndjekjë një politike penale më të butë ndaj të miturve, grave, personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht, personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si dhe zhvillimin e hetimeve të shpejta me qëllim shkurtimin e kohës së hetimit;

- Të ndjekë në vazhdimësi rastet që referohen në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me qëllim sigurimin e pastërtisë së figurës së punonjësve publikë;

- Të thëllojë bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Kontrollin e Lartë i Shtetit, ILDKPKI, me qëllim orientimin e një vizion të përbashkët në politikën shtetërore që duhet të ndiqet në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi, korrupsionit e krimit të organizuar në veçanti;

- Përdorimin e instituteve procedurale si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtëpërdrejtë në mënyrë efektive për t’i shërbyer shpejtësisë së procesit dhe qëllimit të ligjit penal.

- Të vazhdojë të japë kontributin e tij gjithpërfshirës në drejtim të Reformës në Drejtësi, për reformimin e kuadrit ligjor si në aspektin material dhe atë procedural me qëllim përmbushjen e objektivave në këtë fushë;

KRYETARI

Gramoz RUÇI